

**DEKLARATË NË PËRPUTHJE ME NENET 46 DHE 47 TË D.P.R Nr. 445/2000**

Unë i nënshkruari DEPALO Francesco, lindur në Bitonto më 26 gusht 1952 dhe banues si më poshtë, në cilësinë e administratorit të vetëm të shoqërisë “O.M.D - DEPALO SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”, me seli në Bitonto në Rrugën dytësore 231 Km. 7,4, me kapital të shoqërisë 110.000,00 euro (njëqind e dhjetë mijë presje zero zero) tërësisht i shlyer, me kod tatimor, kod TVSh dhe numër regjistrimi në Regjistrin Tregtar të Barit: 03633440726, R.E.A<sup>1</sup> nr. BA – 268078,

i vetëdijshëm për sanksionet penale të parashikuara në nenin 76 të D.P.R nr. 445/2000, në rast të deklaratave të rreme ose që përmbajnë të dhëna jo në përputhje me të vërtetën ose për prodhimin dhe përdorimin e akteve të falsifikuara, pasi është vendosur në dijeni në përputhje me nenin 13 të D. Legjislativ. 196/2003, të referuar në formularin e aplikimit për financim

**DEKLARON**

Nën përgjegjësinë e tij të plotë

- se shoqëria “O.M.D – DEPALO SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”, me seli në adresën Bitonto në Rrugën dytësore 231 Km. 7,4, me kapital të shoqërisë 110.000,00 euro (njëqind e dhjetë mijë presje zero zero) tërësisht i shlyer, me kod tatimor, kod TVSh dhe numër regjistrimi në Regjistrin Tregtar të Barit: 03633440726, R.E.A nr. BA – 268078, gëzon zotësi të plotë për të vepruar, duke mos qenë në likuidim, as në procedurë falimentimi, në proces riorganizimi ose në administrim të kontrolluar;
- që akti i themelimit, certifikata e Dhomës së Tregtisë dhe statuti bashkëngjitur (statuti në fuqi) janë në përputhje ne origjinalin;
- që administrimi i shoqërisë i është besuar administratorit të vetëm zotit DEPALO Francesco, lindur në Bitonto më 26 gusht 1952, me adresë të kryerjes së detyrës në selinë e shoqërisë përmendur më lartë, deri në momentin e revokimit.

(nënshkrimi)

**VËRTETIM NËN SHKRIMI  
REPUBLIKA E ITALISË**

Unë i nënshkruari, doktor Michele Debiase, Noter në Bitonto, me zyrë në rrugën Vittorio Emanuele II nr. 13, dhe anëtar i Dhomës së Noterëve të Barit, vërtetoj se zoti DEPALO Francesco, lindur në Bitonto më 26 gusht 1952, rezident si më poshtë pranë selisë së shoqërisë, shtetas italian, në cilësinë e administratorit të vetëm të shoqërisë “O.M.D. - DEPALO SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”, me seli në Bitonto në Rrugën dytësore 231 Km. 7,4, me kapital të shoqërisë 110.000,00 euro (njëqind e dhjetë mijë presje zero zero)

<sup>1</sup> Shënim i përkthyesit - REPERTORI EKONOMIK ADMINISTRATIV/ REPERTORIO ECONOMICO AMMINISTRATIVO


tërësisht i shlyer, me kod tatimor, kod TVSh dhe numër regjistrimi në Regjistrin Tregtar të Barit: 03633440726, R.E.A nr. BA – 268078, për identitetin e të cilit unë Noteri u sigurova, ka bërë dhe nënshkruar në prezencën time deklaratën më lartë, pasi i bëra me dije për pasojat penale në lidhje me deklaratat e rreme sipas, në bazë dhe përputhje me nenet 3, 47 dhe 76 të D.P.R nr. 445, 28 dhjetor 2000.

Lëshohet për t'u përdorur në përputhje me ligjin.

Në Bitonto, në zyrën time në rrugën Vittorio Emanuele II nr. 13, më njëzet e tre tetor dymijentëmbëdhjetë.

*(vula, nënshkrimi)*

**APOSTILE**

**(Konventa e Hagës e 5 tetor 1961)**

**1.Shteti: ITALIA**

Ky akti publik

**2. është nënshkruar nga MICHELE DEBIASE**

**3.i cili vepron si NOTER**

**4.mban vulën e DEBIASE MICHELE DI ANTONIO  
NOTER NË BITONTO**

**VËRTETUAR**

**5. në Bari**

**6. më 29 tetor 2019**

**7. nga PROKURORIA E REPUBLIKËS**

**8. me numrin 1465**

**9. Vula PROKURORIA E REPUBLIKËS 10. PROKURORI I REPUBLIKËS**

**– BARI-**

Prokurori i Republikës

Dr. Alessio Coccioli


*(nënshkrimi)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
PERKTHYES ZYRTAR

Deklarohet se ky përkthim përputhet me tekstin original ne gjuhen italiane, e është kryer nga **Madena DEROMEMAJ**, përkthyes zyrtar, akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë.

*Madena Deromey*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DHOMA E NOTERISË VLORE  
REP. Nr. 1847

Me anë e të cilit vërtetohet origjinaliteti i nënshkrimit të përkthyesit zyrtar të njohur nga Ministria e Drejtësisë. Znj. **Madena DEROMEMAJ**, , e cila deklaroi se përktheu nga gjuha **italiane** në gjuhën **shqipe** dokumentin bashkëlidhur dhe nënshkroi para meje sipas ligjit.

Vlorë më, 27-12-2019

Noter

*Alketa Jeshalla*



**DICHIARAZIONE AI SENSI DEGLI ARTT 46 E 47 D.P.R. N. 445/2000**


Il sottoscritto DEPALO Francesco, nato a Bitonto il 26 giugno 1952 e domiciliato ove appresso, nella qualità di amministratore unico della società "O.M.D. - DEPALO SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA", con sede in Bitonto alla Strada Provinciale 231 Km. 7,4, capitale sociale Euro 110.000,00 (centodiecimila virgola zero zero) interamente versato, numero di codice fiscale, partita IVA e iscrizione nel Registro delle Imprese di Bari: 03633440726, R.E.A. n. BA - 268078,

consapevole delle sanzioni penali previste dall'art. 76 del D.P.R. n. 445/2000, in caso di dichiarazioni mendaci o contenenti dati non rispondenti a verità e di formazione o uso di atti falsi, preso atto delle informazioni ai sensi dell'art. 13, D.Igs. 196/2003, di cui al modulo di domanda del finanziamento

**DICHIARA**

sotto la propria responsabilità

- che la società "O.M.D. - DEPALO SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA", con sede in Bitonto alla Strada Provinciale 231 Km. 7,4, capitale sociale Euro 110.000,00 (centodiecimila virgola zero zero) interamente versato, numero di codice fiscale, partita IVA e iscrizione nel Registro delle Imprese di Bari: 03633440726, R.E.A. n. BA - 268078, gode del pieno e libero esercizio di tutti i suoi diritti, non essendo in liquidazione, né trovandosi sottoposta a procedure di fallimento, concordato preventivo o amministrazione controllata;
- che l'atto costitutivo, il certificato della Camera di Commercio e l'allegato statuto (statuto vigente) sono conformi agli originali;
- che l'amministrazione della società è affidata all'amministratore unico al medesimo signor DEPALO Francesco, nato a Bitonto il 26 giugno 1952, domiciliato per la carica presso la suddetta sede sociale, sino a revoca.



**AUTENTICA DI FIRMA  
REPUBBLICA ITALIANA**

Certifico io sottoscritto dottor Michele Debiase, Notaio residente in Bitonto, con studio ivi al Corso Vittorio

Emanuele II n. 13, ed iscritto al ruolo presso il Collegio Notarile del Distretto di Bari, che il signor DEPALO Francesco, nato a Bitonto il 26 giugno 1952 domiciliato ove infra presso la sede sociale, cittadino italiano, nella qualità di amministratore unico della società "O.M.D. - DEPALO SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA", con sede in Bitonto alla Strada Provinciale 231 Km. 7,4, capitale sociale Euro 110.000,00 (centodiecimila virgola zero zero) interamente versato, numero di codice fiscale, partita IVA e iscrizione nel Registro delle Imprese di Bari: 03633440726, R.E.A. n. BA - 268078, della cui identità personale sono io Notaio certo, ha reso e sottoscritto in mia presenza la dichiarazione che precede, previo mio richiamo delle conseguenze penali connesse alle dichiarazioni mendaci, ai sensi e per gli effetti del D.P.R. 28 dicembre 2000 n.445, artt.3, 47 e 76.

Si rilascia per gli usi consentiti dalla legge.

Bitonto, nel mio studio al Corso Vittorio Emanuele II n. 13, il giorno ventitre ottobre duemiladiciannove.



**Apostille**  
(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Paese: **ITALIA**

**Il presente atto pubblico**

2. è stato sottoscritto da **MICHELE DEBIASE**

3. agente in qualità di **NOTAIO**

4. è munito del contrassegno / timbro **DEBIASE MICHELE DI ANTONIO**  
**NOTAIO IN BITONTO**

**ATTESTATO**

5. a **Bari**

7. dalla Procura della Repubblica

8. sotto il n. **1465**

9.



10. **IL PROCURATORE DELLA REPUBBLICA**

6. il 29 OTT. 2019

**Il Procuratore della Repubblica Agg.**  
**dott. Alessio Caccioli**

Nr. 40.112 Repertori

Nr. 13.321 Koleksioni --

----- PROCESVERBAL I ASAMBLESË së shoqërisë -----

“O.M.D. DEPALO SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR” (NË INICIALE O.M.D.

----- DEPALO S.R.L.), me seli në Bitonto -----

----- REPUBLIKA E ITALISË -----

Më njëzet e një qershor dymijë e dhjetë, në Molfetta, në studion time në rrugën Umberto nr. 145, në orën shtatëmbëdhjetë. -----

Përpara meje dr. Francesco STELLACI, Noter në Molfetta, i regjistruar në Dhomën e Noterëve të Rajonit të Trani, -----

----- Është paraqitur zoti -----

DEPALO Francesco, lindur në Bitonto më 26 qershor 1952, në cilësinë e Administratorit të Vetëm të Shoqërisë: “O.M.D. DEPALO SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR” (në iniciale O.M.D. DEPALO S.R.L.), me seli në Bitonto, Rruga Inter-urbane 98 Km 74, ku edhe kryen detyrën e tij, kapital i shoqërisë 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë/00) tërësisht i shlyer, me numër kodit tatimor dhe regjistrimi në Regjistrin Tregtar të Shoqërive të Barit 03633440726 (Nr. 268078 i Repertorit Ekonomik Administrativ). -----

I paraqituri i përmendur, për identitetin e të cilit unë noteri u sigurova, më kërkon të hartojë procesverbalin e asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë së lartpërmendur, e cila këtu deklarohet e mbledhur. -----

Duke iu përmbajtur kërkesës që më është bërë, unë Noteri mbaj shënim sa vijon: -----

merr Kryesinë e Asamblesë, në bazë të statutit në fuqi, kërkuesi, zoti DEPALO Francesco, në cilësinë e lartpërmendur,

REGJISTRUAR

Agjencia e të Ardhurave

Zyra Bari 2

Nr. 16645 Seria 1T

06 KORRIK 2010 Euro 324,00

DEPOZITUAR

për regjistrim në

Regjistri Tregtar

Bari më 6 KORRIK 2010

Në nr. 44826



ARKIVI I DHOMËS SË NOTERËVE

Trani

Faqja nr. 1

Shefi i Arkivit

(nënshkrimi)



ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 2  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(vula)

i cili verifikon dhe deklaron: -----

- se është i pranishëm Organi Administrativ, i përfaqësuar nga i paraqituri i përmendur; -----
- se është i pranishëm personalisht, përveç të lartpërmendurit Administrator dhe ortak, i vetmi ortak tjetër, zoti DEPALO Sebastiano (lindur në Bitonto më 13 tetor 1984) dhe për rrjedhojë është i pranishëm i gjithë kapitali i shoqërisë, i ndarë ndërmjet tyre respektivisht në shumën 144.000,00 Euro (njëqind e dyzetë e katër mijë/00) dhe në shumën 16.000,00 Euro (gjashtëmbëdhjetë mijë/00), të barabarta respektivisht me 90% (nëntëdhjetë për qind) dhe 10% (dhjetë për qind)<sup>1/1</sup>, ----- ortakë me të drejtë vote dhe të legjitimuar të marrin pjesë në këtë Asamble; -----
- se nuk është i pranishëm asnjë anëtarë i Bordit të Auditorëve; -----
- se Asambleja është thërritur rregullisht, sipas ligjit dhe statutit, në këtë ditë, orë e vend, në mbledhjen e parë, për të diskutuar dhe vendosur mbi çështjen në vijim të shtruar në rendin e ditës, mbi të cilën të gjithë të pranishmit deklarojnë se janë informuar dhe se nuk e kundërshtojnë trajtimin e çështjeve, më konkretisht: -----

----- Rendi i ditës 2/2 -----

Ndryshim i Nenit 7 të statutit të shoqërisë për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në 110.000,00 Euro dhe rrjedhimisht eliminimin e bordit të auditorëve. -----  
Kryetari, pasi hapi seancën, u siguria për identitetin dhe legjitimimin e ortakëve pjesëmarrës dhe deklaroi





vlefshmërinë e mbledhjes së kësaj Asambleje, në lidhje me pikën e vetme sipas rendit të ditës, parashtron se Shoqëria zotëron mjete financiare, deri në datën e sotme tërësisht  $\frac{3}{3}$  reale dhe të disponueshme, në funksion të kapitalit i cili në lidhje me nevojat reale të shoqërisë dhe objektit të saj është në tepricë. -----

Vlerësimi të tepricës si më sipër i shtohet edhe mungesa e iniciativës ose projekteve tregtare me kohëzgjatje të mesme ose të gjatë të cilat kërkojnë një investime financiare të konsiderueshme, për rrjedhojë - duke mbajtur parasysh çdo aspekt financiar, ekonomik, pasuror dhe fiskal të ndërmarrjes - rezulton në mënyrë të qartë teprica e kapitalit në krahasim me objektivat dhe objektin e shoqërisë. -----

Çka më sipër rezulton edhe nga pasqyrat financiare të fundit të miratuara nga ortakët me vendimin datë 30 prill 2010, të depozituara rregullisht pranë Regjistrimit Tregtar, në të cilat rezulton se viti ushtrimor i fundit është mbyllur me një fitim prej 3.050,00 Euro (tremijë e pesëdhjetë/00) dhe se janë regjistruar në bilanc rezerva dhe fonde të tjerë në një total prej 1.363.923,00 euro (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tremijë e nëntëqind e njëzet e tre/00) -----

Në vijim të sa më sipër, Kryetari propozon zvogëlimin e kapitalit nga 160.000,00 Euro (njëqind e gjashtëdhjetëmijë/00) siç është përmendur dhe më lartë, plotësisht i shlyer dhe i disponueshëm, në 110.000,00 Euro (njëqind e dhjetëmijë/00), duke iu kthyer  $\frac{4}{4}$  ortakëve

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 3  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(nënshkrimi)  
(nënshkrimi)  
(nënshkrimi)



ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 4  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(vula)

në përputhje me kuotën e tyre, sipas parashikimeve dhe afateve të ligjit, vlerën prej 50.000,00 Euro (pesëdhjetëmijë) të kapitalit të tepërt. -----

Në vijim të veprimit të përshkruar, kapitali do të jetë ma pak se minimumi i parashikuar nga ligji për ekzistencën e Bordit të Auditorëve, kështu që është e nevojshme të merret vendim dhe për nevojën e ekzistencës ose jo të Bordit të Auditorëve <sup>5</sup>. Në lidhje me këtë <sup>6</sup>, Kryetari shprehet se anëtarët e këtij Organi, të pranishëm sipas Procesverbalit në Asamblesë së zakonshme datë 3 qershor 2010, nuk kanë shfaqur ndonjë kundërshtim në lidhje me vullnetin e shprehur të ortakëve për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë dhe rrjedhimisht edhe eliminimin e Organit të shoqërisë sipas kushteve të përcaktuar më sipër. -----

Në lidhje me këtë – e mbyll Kryetari - në përputhje me nenin 2445 të kodit civil, referuar në nenin 2496 <sup>7</sup>, vendimi për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë mund të hyjë në fuqi vetëm pasi ka kaluar, pa kundërshtime nga kreditorët, afati prej tre muajsh <sup>8</sup> nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar, kështu që deri në përfundim të këtij afati, kapitali nuk do të konsiderohet i zvogëluar dhe ortakëve nuk mund ti kthehet asnjë vlerë.-----

Me përfundimin e parashtrimit, Kryetari me fton mua noterin të lexoj nenin 7 të statuti në fuqi; me përfundimin e leximit nga unë noteri, Kryetari fton ortakët të marrin vendim në lidhje me çështjen në fjalë. -----

Asambleja e Përgjithshme, pasi dëgjoji relacionin e Kryetarit,



duke pranuar plotësisht propozimin e bërë nga Kryetari, me unanimitet të votave të të gjithë ortakë që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e shoqërisë të shprehura në mënyrë të dukshme,-----

VENDOSI: -----

- të ZVOGËLOJ kapitalin e shoqërisë nga 160.000,00 Euro (njëqind e gjashtëdhjetëmijë/00) në 110.000,00 Euro (njëqind e dhjetëmijë/00), me anë të kthimit të shumës ortakëve në proporcion  $\frac{8}{8}$ , ku, me përfundimin e veprimit, kapitali do të jetë si vijon, 99.000,00 Euro (nëntëdhjetëmijë/00) për ortakun, zotin DEPALO Francesco dhe 11.000,00 Euro (njëmbëdhjetë mijë) për ortakun, zotin DEPALO Sebastiano; -----

- të MOS PËRDORË, për kontrollin e kontabilitetit dhe detyrimet e tjera sipas ligjit, veprimtarinë e Bordit të Auditorëve, duke mbajtur parasysh disponibilitetin e te gjithë anëtarëve për të lënë detyrën për të cilën ishin emëruar, përpara përfundimit normal të mandatit; -----

- të NDRYSHOJË, më përfundimin e afatit dhe plotësimin e kushteve ligjore, nenin 7 të statutit në fuqi si vijon: -----

NENI 7) – KAPITALI I SHOQËRISË -----

Kapitali i shoqërisë është 110.000,00 Euro (njëqind e dhjetëmijë presje zero zero), i ndarë në kuota dhe mund të zmadhohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme procesverbali i të cilës hartohet nga një noter. -----

Kuotat janë të gjitha nominale. -----

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet kundrejt kontributeve të reja ose jo

ARKIVI I  
DHOMËS SË NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 5  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(vula)



ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 6  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(vula)

në përputhje me nenin 2481 – ter të kodit civil, në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme miratuar me të njëjtin numër votash të nevojshëm për ndryshimin e këtij statuti. Vendimi për zmadhimin e kapitali nuk mund të zbatohet për sa kohë nuk janë shlyer tërësisht kontributet e mëparshme. -----

Në rast të një vendimi për zmadhim të kapitalit, ortakët kanë të drejtën e zgjedhjes nëse dëshirojnë të nënshkruajnë kuotat e reja në proporcion të drejtë me kuotat e tyre (e drejta e zgjedhjes). Në vendim duhet të tregohet afati për ushtrimin e të drejtës së zgjedhjes, i cili në asnjë rast nuk mund të jetë më i vogël se tridhjetë ditë nga data në të cilën ortakët njoftohen se kuotat e reja për zmadhimin e kapitalit mund të nënshkruhen. Organi Administrativ duhet të njoftojë të gjithë ortakët e regjistruar në regjistrin e ortakëve nëpërmjet postës rekomande ose dorazi. Ortakët që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes, me kusht që ta kërkojnë shprehimisht, kanë të drejtën e parablerjes në nënshkrimin e kuotave të pa kërkuara nga ortakët e tjerë, përveçse nëse vendimi për zmadhimin e kapitalit e ka përjashtuar këtë të drejtë. Nëse zmadhimi i kapitalit nuk nënshkruhet plotësisht nga ortakët, qoftë duke ushtruar të drejtën e zgjedhjes apo atë të parablerjes për kuotat e pa-kërkuara, Organi Administrativ mund të procedojë me ofrimin palëve të treta jashtë strukturës të shoqërisë, me përjashtim të rastit kur vendimi për zmadhimin e kapitalit parashikon ndryshe. Ortakët që përfaqësojnë



të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë mund të vendosin që nënshkrimi i kuotave të emetuara në kuadër të zmadhimit të kapitalit tu rezervohet palëve të treta jashtë strukturës së shoqërisë; në këtë në këtë rast i takon ortakëve kundërshtues e drejta e largimit sipas nenit 2473 të kodit civil. E drejta e nënshkrimit të kuotave të emetuara rishtazi në kuadër të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë nuk qëndron për ato kuota të emetuara rishtazi të cilat sipas vendimit të ortakëve për zmadhim kapitali duhet të ofrohen kundrejt kontributeve në natyrë; në këtë rast i takon ortakëve kundërshtues e drejta e largimit sipas nenit 2473 të kodit civil. Kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme i cili duhet të merret me shumicën e nevojshme për ndryshimin e këtij statuti. Kontributet për kuotat e shoqërisë kërkohen nga Organi Administrativ në afatet dhe mënyrat që ai i konsideron të dobishme. Kur kapitali nënshkruhet nga ortaku i vetëm atëherë kontributet në para duhet të shlyhen plotësisht me aktin e nënshkrimit. ----

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 7  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(vula)

-----^^-----  
Kryetari më dorëzon tekstin e ri të statutit, i përditësuar me ndryshimet të sapo miratuara dhe që unë noteri ia bashkëngjis këtij akti nën shkronjën "A", duke mos kryer leximin e tekstit në bazë të kërkesës nga i pranishmi. -----

Duke qenë se nuk ka vendime të tjera për tu marrë, mbledhja e Asamblesë konsiderohet e mbyllur



## STATUTI

### NENI 1) – EMRI

Është themeluar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emër “O.M.D. – DEPALO Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”, në initiale “O.M.D. DEPALO S.R.L.”.

### NENI 2) – SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në Rrethin e Bitonto. Organi Administrativ ka kompetencë të hap ose mbyll kudo njësi operative lokale (për shembull degë, filiale dhe zyra përfaqësimi pa seli të qëndrueshme) ose të transferojë selinë brenda territorit të Rrethit të përmendur më sipër; ndërsa hapja dhe mbyllja e adresave dytësore si dhe transferimi i selisë në një Rreth tjetër nga ai i përmendur më sipër i përket ortakëve.

### NENI 3) – OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt veprimtarinë e mëposhtme:

- a) oficinë mekanike për projektimin, ndërtimin, montimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e produkteve në vijim: shkatërrues hidraulik, makineri për lëvizjen e dherave, pjesë këmbimi, pajisje dhe makineri industriale, si dhe tregtimin e tyre;
- b) ekzekutimin e punimeve të karpentierisë për projekte të veta dhe/ ose të kërkuar nga të tretë;
- c) marrja dhe dhënia, përfshirë rastet e ekskluzivitetit me apo pa garanci, kombëtare dhe të huaja, e shërbimeve të agjencisë tregtare ose koncesionarit të produkteve të listuara më sipër në pikën a).

Gjithashtu, shoqëria, jo ndaj publikut të gjerë dhe brenda kufijve të vendosur nga ligji, ka si objekt jo primar ushtrimin e aktiviteteve në vijim:

- fitimin e pjesëmarrjeve me qëllim kryerjen e investimeve të qëndrueshme dhe jo me qëllim shitjen;
- koordinimin tekniko – administrativ të shoqërisë pjesë të të njëjtit grup.

Për arritjen e objektivit shoqëria ka të drejtë të operojë si në Itali ashtu edhe jashtë vendit dhe ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimtaritë tregtare, financiare, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ekonomike dhe industriale, që janë në shërbim ose të lidhura me aktivitetin e përshkruar më sipër, duke përfshirë krijimin e agjentëve, përfaqësuesve, deponuesve dhe të porositurve.

Ajo mundet gjithashtu të fitojë interesa ose pjesëmarrje, drejtpërdrejtë ose jo, në shoqëri të tjera ose ndërmarrje që kanë objekte të përafërta, plotësuese ose strategjikisht të dobishme, qofshin ato me përgjegjësi të kufizuar qofshin me përgjegjësi të pakufizuar.

Shoqëria ka të drejtë të kryejë operacione financiare me natyrë jo mbizotëruese dhe tërësisht aksesore dhe mbështetëse, duke përjashtuar shprehimisht çdo lloji veprimtarie kundrejt publikut të gjerë, mund të marrë financime ose kredi të çfarëdolloj për të favorizuar arritjen e objektit nëpërmjet instituteve të zakonshme të kreditimit, фондеве, etj. Për më tepër

Lidhja "A"  
Nr. 13.321 Kol.

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 9  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)



(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

ka të drejtë të japi dorëzani, garanci mbi titujt dhe çfarëdolloj forme tjetër garancie qoftë në favor të palëve të treta.

Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në respekt dhe brenda kufijve të dispozitave që rregullojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe në respekt të dispozitave në lidhje me aktivitete të kolegejeve, urdhrave dhe profesioneve të regjistruara. Aktivitetet e veçanta me natyrë financiare duhet të kryhen në përputhje me dispozitat ligjore të kësaj fushe.

Shoqëria ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha lehtësirat me natyrë tatimore si dhe financimet me norma interesi të ulëta dhe/ ose grantet të parashikuara nga dispozita të veçanta ligjore.

#### NENI 4) – KOHËZGJATJA

Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar.

Secili ortak ka të drejtën e largimit në përputhje me nenin 2473 – paragrafi 2 të kodit civil.

Shoqëria mund të priset përpara afatit në bazë të një vendimi të asamblesë të marrë në përputhje me ligjin.

#### NENI 5) – VENDBANIMI

Vendbanimi i ortakëve, i administratorëve, audituesve dhe ekspertëve kontabël, nëse janë emëruar, për marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të konsiderohet në çdo rast ai që rezulton në librat e shoqërisë; është detyrimi i ortakut të njoftojë ndryshimin e vendbanimit të vetë

#### NENI 6) – KONTRIBUTET

Mund të jepen si kontribute të gjithë elementët e aktivitetit të cilët mund të jenë objekt i një vlerësimi ekonomik dhe në veçanti mallrat në natyrë, kreditë, puna dhe shërbime në favor të shoqërisë.

#### NENI 7) – KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është 160.000,00 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, i ndarë në kuota dhe mund të zmadhohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme procesverbali i të cilës hartohet nga një noter.

Kuotat janë të gjitha nominale.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet kundrejt kontributeve të reja ose jo në përputhje me nenin 2481 – ter të kodit civil, në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme miratuar me të njëjtin numër votash të nevojshëm për ndryshimin e këtij statuti. Vendimi për zmadhimin e kapitali nuk mund të zbatohet për sa kohë nuk janë shlyer tërësisht kontributet e mëparshme.

Në rast të një vendimi për zmadhim të kapitalit, ortakët kanë të drejtën e zgjedhjes nëse dëshirojnë të nënshkruajnë kuotat e reja në proporcion të drejtë me kuotat e tyre (e drejta e zgjedhjes). Në vendim duhet të tregohet afati për ushtrimin e të drejtës së zgjedhjes, i cili në asnjë rast nuk mund të jetë më i ulët se tridhjetë ditë nga data në të cilën ortakët njoftohen se kuotat e reja për zmadhimin e kapitalit mund të nënshkruhen.



Organi Administrativ duhet të njoftojë të gjithë ortakët e regjistruar në regjistrin e ortakëve nëpërmjet postës rekomande ose dorazi. Ortakët që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes, me kusht që ta kërkojnë shprehimisht, kanë të drejtën e parablerjes në nënshkrimin e kuotave të pa kërkuara nga ortakët e tjerë, përveçse nëse vendimi për zmadhimin e kapitalit e ka përjashtuar këtë të drejtë. Nëse zmadhimi i kapitalit nuk nënshkruhet plotësisht nga ortakët, qoftë duke ushtruar të drejtën e zgjedhjes apo atë të parablerjes për kuotat e pa-kërkuara, Organi Administrativ mund të procedojë me ofrimin palëve të treta jashtë strukturës të shoqërisë, me përjashtim të rastit kur vendimi për zmadhimin e kapitalit parashikon ndryshe.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë mund të vendosin që nënshkrimi i kuotave të emetuara në kuadër të zmadhimit të kapitalit tu rezervohet palëve të treta jashtë strukturës së shoqërisë; në këtë rast i takon ortakëve kundërshtues e drejta e largimit sipas nenit 2473 të kodit civil.

E drejta e nënshkrimit të kuotave të emetuara rishtazi në kuadër të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë nuk qëndron për ato kuota të emetuara rishtazi të cilat sipas vendimit të ortakëve për zmadhim kapitali duhet të ofrohen kundrejt kontributeve në natyrë; në këtë rast i takon ortakëve kundërshtues e drejta e largimit sipas nenit 2473 të kodit civil.

Kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji në bazë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme i cili duhet të merret me shumicën e nevojshme për ndryshimin e këtij statuti.

Kontributet për kuotat e shoqërisë kërkohen nga Organi Administrativ në afatet dhe mënyrat që ai i konsideron të dobishme.

Kur kapitali nënshkruhet nga ortaku i vetëm atëherë kontributet në para duhet të shlyhen plotësisht me aktin e nënshkrimit.

#### NENI 8) – FINANCIMET E ORTAKËVE DREJT SHOQËRISË

Financimet me të drejtë kthimi të shumës së dhënë mund të kryhen nga ortakët edhe pa qenë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në shoqëri, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Përveçse kur është vendosur ndryshe, derdhjet e kryera nga ortakët në favor të shoqërisë duhet të konsiderohen të pa frytshme.

#### NENI 9) – TË DREJTAT E ORTAKËVE

Të drejtat nga kuota mbi shoqërinë i takojnë çdo ortaku në proporcion me kuotën e tyre. Në rastin e bashkëpronësisë së kuotave, të drejtat e bashkëpronarëve do të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i emëruar në përputhje me nenet 1105 dhe 1106 të kodit civil.

Cilësia si ortak provohet nga regjistrimi në regjistrin e ortakëve dhe kufizimet reale mbi kuotat krijohen

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 11  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)





vetëm nëpërmjet shënimit të tyre në këtë libër.

E drejta e zgjedhjes dhe e parablerjes si dhe të drejtat reale mbi kuotat mund t'u cedohen të tretëve me shpërblim dhe/ ose pa shpërblim, vetëm nëse jepet miratimi nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 10) – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Në rast të transferimit ndërmjet të gjallëve të kuotave, të të drejtës së zgjedhjes në rastin e zmadhimit të kapitalit ose të së drejtës së parablerjes për kuotat e pa kërkuara, i përket ortakëve të tjerë e drejta e parablerjes. E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rast se transferimi kryhet në favor të ortakëve të tjerë. Me "transferim ndërmjet të gjallëve" në kuadër të këtij neni, kuptohen të përfshirë të gjithë veprimet e tjetërsimit, në kuptimin më të gjerë të termit, pra, për rrjedhojë, përveç shitjes, për shembull, përfshihet dhe kontrata e shkëmbimit, dhënies kundrejt pagesës dhe dhurimi.

E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet pjesërisht, pra duhet të ushtrohet për të gjitha kuotat objekt transaksioni; në rast se asnjë ortak nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ose në rast se e drejta ushtrohet vetëm për një pjesë të asaj që ofrohet, atëherë ortaku propozues do të jetë i lirë të transferojë të gjithë objektin e propozimit për transferim personit të treguar në vetë propozimin, sipas kushteve të përcaktuara aty. Ortaku që dëshiron të kryejë transferimin e kuotës së vetë kundrejt shpërblimit me sende të zëvendësueshme, duhet që fillimisht t'i dërgojë ofertën me të njëjtat kushte ortakëve të tjerë, nëpërmjet Organit Administrativ, të cilit duhet t'i njoftojë objektin e transferimit, çmimin e kërkuar, kushtet e pagesës, të dhënat e sakta të blerësit të mundshëm person i tretë si dhe afatet kohore për nënshkrimin e aktit të transferimit.

Brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes së njoftimit si më sipër, Organi Administrativ duhet t'i njoftojë propozimin për transferim të gjithë ortakëve të regjistruar në regjistrin e ortakëve në datën e njoftimit të marrë, duke ju caktuar atyre një afat prej njëzet ditësh nga data e njoftimit për të ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes. Brenda kësaj data ortakët duhet t'i njoftojnë Organit Administrativ nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, në rast të kundërt kjo e drejtë bie në dekadencë.

Në rast se asnjë nga ortakët nuk dëshiron të blejë kuotën e ofruar sipas afateve dhe mënyrave të përcaktuara më sipër, atëherë ortaku që shet është i lirë t'i transferojë kuotën blerësit të treguar në njoftim brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data në të cilën ka mbaruar afati për të ushtruar të drejtën e parablerjes; në rast të kundërt procedura si më sipër duhet të përsëritet nga e para.

Në rast se ortakut i refuzohet e drejta që të shes kuotën e tij, atëherë ai ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e largimit sipas nenit 2473 të kodit civil. Paga për shlyerjen e kuotës për të cilën është ushtruar



e drejta e largimit duhet të kryhet brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data në të cilën ortaku ka njoftuar shoqërinë. Në rastet kur bëhet fjalë për transferim ndërmjet të gjallëve pa shpërblim, ortakëve të tjerë u takon e drejta e parablerjes sipas parashikimeve të më sipërme për aq sa janë të aplikueshme, me ndryshimin e vetëm se ortaku i cili ushtron të drejtën e parablerjes do të duhet t'i jap dhuruesit një shumë të barabartë me vlerën e kuotës për të cilën është ushtruar e drejta e parablerjes. Kjo vlerë do të përcaktohet me mirëkuptim ndërmjet palëve duke iu referuar vlerës së shoqërisë në datën në të cilën Organi Administrativ ka marrë njoftimin nga ortaku i cili dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes. Transferimi i kryer në kundërshtim me parashikimet që rregullojnë të drejtën e parablerjes sipas këtij neni nuk mund t'i kundër drejtohet shoqërisë apo ortakëve.

#### NENI 11) – TRANSFERIMI I KUOTAVE PËR MORTIS CAUSA

Në rast të vdekjes së një prej ortakëve, i takon ortakëve të tjerë të vendosin nëse do të lejojnë transferimin e kuotës në favor të trashëgimtarëve. Në rast se këtyre të fundit ju mohohet e drejta që të trashëgojnë pozicionin si ortak në shoqëri, atëherë ata kanë të drejtë të kërkojnë largimin nga shoqëria në përputhje me nenin 2437 të kodit civil. Në këtë rast, ortakët e tjerë duhet t'u shlyejnë trashëgimtarëve të ortakut që ka vdekur vlerën e kuotës që i takonte ortakut që ka vdekur, e përcaktuar sipas të njëjtës mënyrë me të cilën përcaktohet vlera e kuotës së ortakut që largohet; pagesa përkatëse duhet t'i bëhet nga shoqëria trashëgimtarëve të të ndierit sipas marrëveshjes ndërmjet palëve dhe në rast të mungesës së një marrëveshjeje pagesa do të kryhet në tre këste të barabarta brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë), 360 (treqind e gjashtëdhjetë) dhe 540 (pesëqind e dyzetë) ditëve nga data në të cilën është përcaktuar përfundimisht vlera e kuotës. Mbi këto këste do të llogariten dhe do t'u paguhen trashëgimtarëve të të ndierit interesat ligjore duke filluar nga data e vdekjes deri në datën e kryerjes së pagesës. Në rast të ndërhyrjes të më shumë trashëgimtarëve apo legatarëve në kuotën e të ndierit, ata do të emërojnë një përfaqësues të përbashkët.

#### NENI 12) – LARGIMI I ORTAKUT

Në rast të krijimit apo rikrijimit të pluralitetit të ortakëve, ortaku ka të drejtë të largohet nga shoqëria, për të gjitha ose një pjesë të kuotave të tij, në rastet e parashikuara nga neni 2437 i kodit civil.

Ortaku që dëshiron të largohet duhet t'i njoftojë vendimin e tij Organit Administrativ nëpërmjet një letre rekomande të dërguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të vendimit në Regjistrin Tregtar ose nga data e transkriptimit të saj në regjistrin e vendimeve të ortakëve. - Në rast se fakti që përbën shkakun e largimit është i ndryshëm nga një vendim personal i ortakut, atëherë ortaku ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e tij brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data në të cilën ka marrë

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 13  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)



dijeni mbi këtë fakt. Në njoftim duhet të tregohet vlera nominale e kuotave për të cilat ushtrohet e drejta e largimit.

Organi Administrativ duhet t'i njoftojë menjëherë ortakëve ato fakte që mund të përbëjnë shkak për të ushtruar të drejtën e largimit.

E drejta e largimit konsiderohet se është ushtruar ditën në të cilën letra rekomande ka mbërritur në adresën e selisë së shoqërisë.

Kuotat për të cilat është ushtruar e drejta e largimit janë të patjetërsueshme.

Shlyerja e kuotave për të cila është ushtruar e drejta e largimit kryhet në bazë të nenit 2437 të kodit civil. Shlyerja si më sipër mund të kryhet nëpërmjet blerjes së kuotës nga ortakët që ngelen në shoqëri në përpjesëtim me kuotat e tyre; ose në rast të kundërt është e mundur që kuota të blihet nga një person i tretë për të cilin është rënë dakord.

E drejta e largimit nuk mund të ushtrohet dhe nëse është ushtruar është nul dhe pa vlerë në rast se brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e ushtrimit të së drejtës së largimit, shoqëria ka revokuar vendimin që legjitimon largimin ose në rast se është vendosur prishja e shoqërisë.

Megjithatë, në rast se si pasojë e shlyerjes nga shoqëria të kuotës së ortakut të larguar, kapitali i shoqërisë zvogëlohet nën minimumin e kërkuar ligjor, atëherë të gjithë ortakët që mbeten në shoqëri duhet që më përpara ose njëkohësisht me shlyerjen, në përpjesëtim me kuotat e tyre, të risjellin kapitalin e shoqërisë në një vlerë jo më të vogël se minimumi i kërkuar nga ligji ose të procedojnë me transformimin e shoqërisë ose me prishjen e shoqërisë.

#### NENI 13) – PËRJASHTIMI I ORTAKUT

Do të përjashtohet nga shoqëria ortaku:

- që nuk ka shlyer kontributet në afatet e përcaktuara dhe nuk ka qenë e mundur të procedohet me shitjen e kuotës së tij në përputhje me nenin 2466 të kodit civil;
- që ka kontribuar në shoqëri me punë ose shërbime por nuk është më në gjendje të ofrojë punën apo shërbimet si kontribut;
- që është deklaruar i paaftë të veprojë, është deklaruar i falimentuar ose i dënuar më një dënim të formës së prerë që përfshinë ndalimin, qoftë të përkohshëm, të mbajtjes së posteve publike;

Vendimi për përjashtim duhet të merret nga ortakët që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitali të shoqërisë. Në llogaritjen e shumicës nuk do të merret parasysh kuota e ortakut për të cilin do të merret vendimi i përjashtimit.

Organi Administrativ do t'i njoftojë ortakut përjashtimin e tij, i cili do të hyjë në fuqi pas kalimit të tridhjetë ditëve nga data e njoftimit.

Brenda kësaj periudhe, ortaku i përjashtuar mund të bëjë ankesë



përpara Kolegjit të Arbitrazhit.

Ortaku i përjashtuar ka të drejtën e likuidimit të kuotës së tij në përputhje me nenin 2437 të kodit civil.

#### NENI 14) – ORTAKU I VETËM

Në rast se i gjithë kapitali i përket vetëm një ortaku ose në rast se ndryshon ortaku i vetëm, atëherë Organi Administrativ duhet të përmbushë detyrimet e parashikuara nga neni 2470 i kodit civil. Kur krijohet ose rikrijohet pluraliteti i ortakëve, atëherë Organi Administrativ duhet të depozitojë deklaratën përkatëse që të regjistrohet pranë Regjistrisë Tregtar.

Ortaku i vetëm ose ai i cili nuk është më i tillë mund të kujdeset për kryerjen e publikimit të parashikuar nga paragrafi më lart.

Deklaratat e Organit të Administrimit duhet më pas të shënohen në regjistrin e ortakëve brenda 30 (tridhjetë) nga data e regjistrimit në Regjistrinë Tregtar, duke treguar dhe datën e regjistrimit.

#### NENI 15) – VENDIMET E ORTAKËVE

Ortakët marrin vendime mbi çështjet që janë në kompetencën e tyre në bazë të ligjit, aktit të themelimit dhe këtij statuti, si dhe mbi çështjet që një ose më shumë administrator ose ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë paraqesin për votim. Në çdo rast, ortakët kanë kompetencën mbi:

- a. miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimit;
- b. emërimin e administratorëve dhe strukturën e Organit të Administrimit;
- c. sipas rastit, emërimin e auditorëve dhe Kryetarit të Bordit të Auditimit ose të ekspertit kontabël;
- d. ndryshimin e aktit të themelimit;
- e. vendimin për kryerjen e veprimeve që përfshijnë ndryshimin thelbësor të objektit ose një ndryshim domethënës të të drejtave të ortakëve, si dhe marrjen e kuotave nga të cilat rrjedh një përgjegjësi e pakufizuar nga detyrimet e shoqërisë kuotat e të cilës janë fituar;
- f. vendimet për prishjen para kohe të shoqërisë si dhe revokimin e këtij vendimi; emërimin, shkarkimin dhe zëvendësimin e likuiduesve dhe përcaktimin e kriterëve për kryerjen e likuidimit; vendimet që ndryshojnë vendimet e marra në bazë të paragrafit të parë të nenit 2487 të kodit civil;
- g. vendimin në lidhje me përjashtimin e një ortaku.

Në çdo rast kur zbatohet metoda e marrjes së një vendimi mbi bazën e konsultimeve me shkrim, ortaku i cili dëshiron të konsultojë ortakët e tjerë dhe t'ju propozojë atyre marrjen e një vendimi të caktuar, e formulon propozimin e tij me shkrim, në çfarëdolloj forme (letër ose magnetike), ku tregon objektin e propozimit dhe arsyet përse duhet të merret vendimi, si dhe vendos nënshkrimin e tij në letër ose në formë elektronike.

Konsultimi me shkrim konsiston në dërgimin e një propozimi për marrje vendimi drejtuar të gjithë ortakëve me të drejtë vote, në çfarëdolloj forme që lejon verifikimin e marrjes dijeni, në adresat e regjistruara

ARKIVI I DHOMËS SË  
NOTERËVE

Trani  
Faqja nr. 15  
Shefi i Arkivit  
(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)



në regjistrin e ortakëve. Në propozim duhet të tregohen me qartësi çështja objekt konsultimi, arsyet dhe çdo gjë që është e nevojshme për të siguruar një informim të mjaftueshëm mbi çështjen që do të shqyrtohet, si dhe duhet të jepet teksti ekzakt i vendimit që duhet të merret. Ortakët duhet të dorëzojnë përgjigjen e tyre në selinë e shoqërisë, brenda afatit të përcaktuar në propozim, me çfarëdolloj forme e cila lejon verifikimin e marrjes dijeni. Përgjigja duhet të përmbajë një miratim (i cili përmban një deklaratë se ortaku është informuar mjaftueshëm mbi çështjen), një refuzim ose një abstenim të shprehur. Mos kthimi i një përgjigje nga ortakët brenda afatit të përcaktuar konsiderohet si votë kundër.

